




INDEKSI I TRANSPARENCËS PROAKTIVE TË 61 NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

RAPORT MONITORIMI

DHJETOR 2020



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

Raport Monitorimi

Transparenca Proaktive e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Monitorimi u krye nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Raporti u hartua nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Përmbajtja

Hyrje.....	4
Metodologjia.....	6
Monitorimi	8
Indeksi i Transparencës Proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.....	11
Gjetjet përfundimtare.....	15

Hyrje

E drejta për informim është e drejta e qytetarëve për të patur akses në dokumente zyrtare dhe detyrimi i autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë pa kërkuar motivet. E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë e cila pas miratimit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” ka sjell një garanci më të madhe ligjore për aksesin e qytetarëve në informacion dhe kushtet e duhura të transparencës proaktive për të ushtruar të drejtat e tyre.

Një nga risitë e Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është dhe përgatitja dhe miratimi i programeve të transparencës sipas Modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Nëpërmjet Programit të Transparencës, i cili publikohet në faqen zyrtare, bashkitë vendosin në dispozicion të qytetarëve një kategori të gjerë informacionesh, mënyrat dhe afatet e publikimit të tyre, si dhe procedurat për të aksesuar e përdorur ato.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 ka miratuar “Programin Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, i cili është i detyrueshëm për 61 bashkitë e vendit prej 1 janarit 2019. Programi Model është hartuar në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe i përshtatur në kontekstin e vetëqeverisjes vendore në përputhje dhe në zbatim të Kushtetutës, ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe të ligjit nr. 8548, datë 11.11.1999 “Për ratifikimin e “Kartës evropiane të autonomisë vendore”.

Një nga fazat e rëndësishme në sigurimin e transparencës në nivel vendor është edhe monitorimi i zbatimit të Programit të Transparencës. Monitorimi lejon të vlerësohet niveli i transparencës në nivel bashkie. Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e cila mbikëqyr respektimin e dispozitave të ligjit për të drejtën e informimit dhe në rastet kur vërehen mosrespektimi i tyre, bën vlerësimin e kundërvajtjes dhe vendos masën administrative përkatëse.

Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me UNDP Albania ka kryer monitorimin e parë të zbatimit të Programit Model të Transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë muajit shtator të vitit 2019 dhe rezultatet e dala nga ky raportim i janë dërguar të gjitha bashkive. Në fund të vitit 2019, Zyra e Komisionerit realizoi një monitorim të dytë duke vërejtur se 57 nga 61 bashki e kishin miratuar Programin Model të Transparencës.

Transparenca proaktive nëpërmjet publikimit të informacioneve në Programin e Transparencës kërkon një impenjimin të institucioneve publike për ta përditësuar dhe plotësuar me informacion në mënyrë të vazhdueshme. Për këtë arsye, monitorimi i transparencës të njëjësive të vetëqeverisjes vendore kryhet në bazë vjetore, duke lehtësuar kështu kryerjen e analizave krahasimore në të ardhmen. Gjatë vitit 2020, Zyra e Komisionerit ka monitoruar sërish zbatimin e Programit Model të Transparencës, por kësaj radhe duke sjellë një metodologji të re e cila lejon krahasimin midis 61 njëjësive të vetëqeverisjes vendore si dhe evidenton në mënyrë të qartë dhe koncize mangësitë më të mëdha të atyre njëjësive të vetëqeverisjes vendore të cilat nuk i kanë përmbushur detyrimet ligjore që burojnë nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e

informimit” dhe VKM 145/2018 “Për ngritjen e bazës së të dhënave shtetërore Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit (REKPMI)”.

Gjetjet e këtij monitorimi dhe indeksi synojnë jo vetëm të nxisin njësitë e vetëqeverisjes vendore për të rritur nivelin e transparencës përmes publikimit proaktiv të informacionit por të shërbejnë dhe si një referencë përpara vendimmarrjes së Zyrës së Komisionerit në respektim të dispozitave ligjore.

Metodologjia

Sistemi i matjes i përdorur në këtë monitorim i referohet 4 treguesve kryesorë të cilët bëjnë vlerësimin objektiv të nivelit funksional të transparencës proaktive të njësive të vetëqeverisjes vendore. Numri total i pikëve të vlerësimit të treguesve është 4 (katër). Bazuar në pikëzimin e çdo treguesi llogaritet shuma totale e vlerësimit për secilën bashki.

Instrumentet kryesore për matjen e transparencës proaktive janë publikimi i Programit Model të Transparencës në faqen zyrtare të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe regjistrimi në bazën e të dhënave shtetërore “Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit (REKPMI)”. Kërkimi në internet është përdorur për të vlerësuar treguesit duke vlerësuar gjendjen reale në momentin e kërimit.

Sistemi i matjes i përdorur në këtë metodologji është i thjeshtë dhe lejon një vlerësim të shpejtë të treguesve bazuar në gjendjen reale të tyre në momentin e kërimit në faqen zyrtare të internetit të bashkisë dhe në portalin *pyetshtetin.al*. Ky sistem krijon mundësinë e përdorimit të menjëhershëm për shkak të lehtësisë së përdorimit dhe shpejtësisë në arritjen e përfundimeve në lidhje me përcaktimin e nivelit të transparencës.

Sistemi i Matjes së Transparencës përfshin 4 tregues të transparencës me qëllim për të matur dhe raportuar në mënyrë periodike nivelin e transparencës të secilës bashki. Një sistem i tillë i shërben kryesisht Zyrës së Komisionerit si një bazë për të monitoruar nivelin funksional të transparencës të secilës bashki, me qëllim për të evidentuar progresin, pikët e dobëta dhe të forta. Gjithashtu, ky raport shërben dhe si një referencë përpara vendimmarrjes së Zyrës së Komisionerit në respektim të dispozitive ligjore.

Treguesi i parë

Publikimi i Programit Model të Transparencës për Njësitet e Vetëqeverisjes Vendore

Pikët:

Vlerësimi: 0 - informacioni nuk ekziston

1- informacioni ndodhet i publikuar

Treguesi i dytë

Publikimi i Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve i përditësuar gjatë vitit 2020

Pikët:

Vlerësimi: 0 - informacioni nuk ekziston

1 - informacioni ndodhet i publikuar

Treguesi i tretë

Emër Mbiemër Koordinatori për të Drejtën e Informimit

Pikët:

Vlerësimi: 0 - informacioni nuk ekziston

1- informacioni ndodhet i publikuar

Treguesi i katërt

Regjistri Elektronik për Kërkesat dhe Përgjigjet për të Drejtën e Informimit i instaluar

Pikët:

Vlerësimi: 0 - informacioni nuk ekziston

1- informacioni ndodhet i publikuar


Ky sistem matje i transparencës proaktive ngjan me një sistem semafori.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore që i kanë të gjithë treguesit negativ dhe për këtë arsye kanë grumbulluar 0 pikë, kanë një transparencë proaktive negative dhe në semafor janë shënuar me dritë të kuqe.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore që kanë 1 nga të 4-tër treguesit e monitorimit pozitiv, pra të vlerësuar me 1 pikë ndërsa 3 të tjerët janë vlerësuar me 0 pikë, kanë një transparencë proaktive të pamjaftueshme dhe në semafor janë shënuar me dritë të verdhë.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore që kanë grumbulluar 2-3 pikë, pra që kanë minimumi 2 tregues pozitiv dhe maksimumi 3 tregues pozitiv, kanë një transparencë proaktive minimale dhe në semafor janë shënuar me dritë të bardhë.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat i kanë të gjithë treguesit pozitiv dhe kanë grumbulluar 4 pikë kanë një transparencë proaktive funksionale dhe në semafor janë shënuar me dritë të gjelbër.



Semafor i Kuq - Transparencë Proaktive Negative

Semafor i Verdhë - Transparencë Proaktive të Pamjaftueshme

Semafor i Bardhë - Transparencë Proaktive Minimale

Semafor i Gjelbër - Transparencë Proaktive Funksionale

Monitorimi

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoroi gjatë muajit nëntor 2020 faqet zyrtare të 61 njësive të vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit me qëllim realizimin e raportit monitoroi dhe bazën shtetërore të të dhënave “Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit (REKPDI)”, e cila është e publikuar në portalin *pyetshtetin.al*. Qëllimi i monitorimit është vlerësimi i nivelit të transparencës proaktive funksionale në nivel bashkie.

Në tabelën e mëposhtme janë evidentuar katër treguesit kryesorë të monitorimit të cilat janë: publikimi i programit të transparencës sipas Urdhrit nr.211, datë 10.09.2018 “Për Miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”; publikimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve i përditësuar në vitin 2020, publikimi i emrit dhe mbiemrit të koordinatorit për të drejtën e informimit dhe instalimi i regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit sipas VKM 145/2018 “Për ngritjen e bazës së të dhënave shtetërore Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit (REKPDI).

Në përfundim të monitorimit të kryer rezultojnë se 3 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë një “Transparencë Proaktive Negative” (semafor i kuq); 18 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “Transparencë Proaktive të Pamjaftueshme (semafor i verdhe); 27 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “Transparencë Proaktive minimale (semafor i bardhë) dhe 13 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “Transparencë Proaktive Funksionale” (semafor i gjelbër).

	Autoritete Publike	Program Transparence	Regjistër i kërkesave dhe përgjigjeve	Koordinator	Regjistri elektronik	Pikët Total
1	Bashkia Belsh	1	0	1	0	2
2	Bashkia Berat	1	0	1	1	3
3	Bashkia Bulqizë	0	0	1	0	1
4	Bashkia Cërrik	1	0	1	0	2
5	Bashkia Delvinë	1	0	0	0	1
6	Bashkia Devoll	1	0	0	1	2
7	Bashkia Dibër	1	1	1	1	4
8	Bashkia Divjakë	1	0	0	0	1
9	Bashkia Dropull	1	0	1	0	2
10	Bashkia Durrës	1	1	1	1	4
11	Bashkia Elbasan	1	0	1	1	3
12	Bashkia Fier	1	0	1	1	3
13	Bashkia Fiq	0	0	0	0	0

14	Bashkia Fushë-Arrëz	1	0	0	0	1
15	Bashkia Gjirokastrë	0	1	1	1	3
16	Bashkia Gramsh	1	1	1	1	4
17	Bashkia Has	1	0	0	0	1
18	Bashkia Himarë	0	0	1	1	2
19	Bashkia Kamëz	1	0	1	1	3
20	Bashkia Kavajë	1	0	0	0	1
21	Bashkia Këlcyrë	1	0	0	0	1
22	Bashkia Klos	1	1	1	1	4
23	Bashkia Kolonjë	1	0	1	1	3
24	Bashkia Konispol	1	0	0	0	1
25	Bashkia Korçë	1	1	1	1	4
26	Bashkia Krujë	0	1	1	0	2
27	Bashkia Kuçovë	1	1	0	0	2
28	Bashkia Kukës	1	1	0	1	3
29	Bashkia Kurbin	0	0	1	0	1
30	Bashkia Lezhë	1	1	1	1	4
31	Bashkia Libohovë	1	0	1	0	2
32	Bashkia Librazhd	1	1	1	0	3
33	Bashkia Lushnjë	1	0	1	0	2
34	Bashkia Malësi e Madhe	0	1	0	0	1
35	Bashkia Maliq	1	0	1	1	3
36	Bashkia Mallakastër	1	1	1	0	3
37	Bashkia Mat	1	1	1	1	4
38	Bashkia Memaliaj	1	0	0	1	2
39	Bashkia Mirditë	1	1	1	0	3
40	Bashkia Patos	1	1	1	1	4
41	Bashkia Peqin	1	1	1	0	3
42	Bashkia Përmet	1	0	1	0	2

43	Bashkia Pogradec	0	1	0	0	1
44	Bashkia Poliçan	1	0	0	1	2
45	Bashkia Prrenjas	1	0	0	0	1
46	Bashkia Pukë	0	0	0	0	0
47	Bashkia Pustec	1	0	0	0	1
48	Bashkia Roskovec	1	1	1	0	3
49	Bashkia Rrogozhine	0	0	0	0	0
50	Bashkia Sarandë	1	0	0	0	1
51	Bashkia Selenice	1	0	0	1	2
52	Bashkia Shijak	1	1	1	1	4
53	Bashkia Shkodër	1	1	1	1	4
54	Bashkia Skrapar	1	1	1	1	4
55	Bashkia Tepelenë	1	0	0	0	1
56	Bashkia Tiranë	1	1	1	1	4
57	Bashkia Tropojë	0	1	0	0	1
58	Bashkia Ura Vajgurore	0	0	1	0	1
59	Bashkia Vau i Dejës	1	1	0	0	2
60	Bashkia Vlorë	1	1	1	1	4
61	Bashkia Vorë	1	0	0	0	1
	Total	49	26	37	26	

Indeksi i Transparencës Proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Njësitet e vetëqeverisjes vendore janë renditur në Indeksin e Transparencës Proaktive sipas rezultateve të monitorimit bazuar në metodologjinë e semaforit, duke vendosur në fillim të listës njësitet e vetëqeverisjes vendore të cilat kanë grumbulluar 4 pikë, më poshtë ato njësi të cilat kanë grumbulluar 3 pikë, pastaj ato me 2 pikë, poshtë tyre ato me 1 pikë dhe në fund ato me 0 pikë. Renditja e njësive të vetëqeverisjes vendore me tw njëjtin numër pikësh është kryer sipas alfabetit.

Indeksi i Transparencës Proaktive të të gjitha njësive të vetëqeverisjes vendore.

	Autoritete Publike	Program Transparence	Regjistër i kërkesave dhe përgjigjeve	Koordinator	Regjistri elektronik	Pikët Total
1	Bashkia Dibër	1	1	1	1	4
2	Bashkia Durrës	1	1	1	1	4
3	Bashkia Gramsh	1	1	1	1	4
4	Bashkia Klos	1	1	1	1	4
5	Bashkia Korçë	1	1	1	1	4
6	Bashkia Lezhë	1	1	1	1	4
7	Bashkia Mat	1	1	1	1	4
8	Bashkia Patos	1	1	1	1	4
9	Bashkia Shijak	1	1	1	1	4
10	Bashkia Shkodër	1	1	1	1	4
11	Bashkia Skrapar	1	1	1	1	4
12	Bashkia Tiranë	1	1	1	1	4
13	Bashkia Vlorë	1	1	1	1	4
14	Bashkia Berat	1	0	1	1	3

15	Bashkia Elbasan	1	0	1	1	3
16	Bashkia Fier	1	0	1	1	3
17	Bashkia Gjirokastrë	0	1	1	1	3
18	Bashkia Kamëz	1	0	1	1	3
19	Bashkia Kolonjë	1	0	1	1	3
20	Bashkia Kukës	1	1	0	1	3
21	Bashkia Librazhd	1	1	1	0	3
22	Bashkia Maliq	1	0	1	1	3
23	Bashkia Mallakastrë	1	1	1	0	3
24	Bashkia Mirditë	1	1	1	0	3
25	Bashkia Peqin	1	1	1	0	3
26	Bashkia Roskovec	1	1	1	0	3
27	Bashkia Belsh	1	0	1	0	2
28	Bashkia Cërrik	1	0	1	0	2
29	Bashkia Devoll	1	0	0	1	2
30	Bashkia Dropull	1	0	1	0	2
31	Bashkia Himarë	0	0	1	1	2
32	Bashkia Krujë	0	1	1	0	2
33	Bashkia Kuçovë	1	1	0	0	2


34	Bashkia Libohovë	1	0	1	0	2
35	Bashkia Lushnjë	1	0	1	0	2
36	Bashkia Memaliaj	1	0	0	1	2
37	Bashkia Përmet	1	0	1	0	2
38	Bashkia Poliçan	1	0	0	1	2
39	Bashkia Selenice	1	0	0	1	2
40	Bashkia Vau i Dejës	1	1	0	0	2
41	Bashkia Bulqizë	0	0	1	0	1
42	Bashkia Delvinë	1	0	0	0	1
43	Bashkia Divjakë	1	0	0	0	1
44	Bashkia Fushë-Arrëz	1	0	0	0	1
45	Bashkia Has	1	0	0	0	1
46	Bashkia Kavajë	1	0	0	0	1
47	Bashkia Këlcyrë	1	0	0	0	1
48	Bashkia Konispol	1	0	0	0	1
49	Bashkia Kurbin	0	0	1	0	1
50	Bashkia Malësi e Madhe	0	1	0	0	1
51	Bashkia Pogradec	0	1	0	0	1
52	Bashkia Prrrenjas	1	0	0	0	1

53	Bashkia Pustec	1	0	0	0	1
54	Bashkia Sarandë	1	0	0	0	1
55	Bashkia Tepelenë	1	0	0	0	1
56	Bashkia Tropojë	0	1	0	0	1
57	Bashkia Ura Vajgurore	0	0	1	0	1
58	Bashkia Vorë	1	0	0	0	1
59	Bashkia Finiq	0	0	0	0	0
60	Bashkia Pukë	0	0	0	0	0
61	Bashkia Rrogozhinë	0	0	0	0	0

Gjetjet përfundimtare

Në konkluzion të monitorimit të Transparencës Proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore vërejmë se në krahasim me vitin 2019 kemi një ulje të transparencës proaktive, veçanërisht në 3 indikatorët e parë të metodologjisë dhe konkretisht, për sa i përket “publikimit të Programit Model të Transparencës”, “përditësimin të regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve për vitin 2020” dhe “publikimin e të dhënave të koordinatorit për të drejtën e informimit”. Për sa i përket indikatorit të katërt “Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit (REKPDİ)” është i vetmi indikator që ka njohur rritje.

Rezultatet e këtij monitorimi tregojnë se janë 49 Njësi të Vetëqeverisjes Vendore që e kanë publikuar Programin Model të Transparencës (qoftë edhe formalisht) sipas *Urdhrit nr. 211, datë 10.09.2018 “Për Miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”*, i cili është i detyrueshëm për 61 bashkitë e vendit. Krahasuar me një vit më parë ishin 57 njësi të vetëqeverisjes vendore që kanë raportuar tek Zyra e Komisionerit për miratimin e Programit Model të Transparencës. Në lidhje me regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, monitorimi evidenton me pikë pozitive vetëm ato raste kur regjistri është përditësuar gjatë vitit 2020. Numri total i njësive të vetëqeverisjes vendore të cilët kanë përditësuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve është 26, çka përbën pak më shumë se 42% të njësive të vetëqeverisjes vendore që kanë zbatuar detyrimin ligjor për përditësimin e regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve. Për sa i përket të dhënave të koordinatorëve për të drejtën e informimit rezultojnë se 37 prej njësive të vetëqeverisjes vendore, pra pak më shumë se 60% e tyre kanë publikuar dhe përditësuar të dhënat e koordinatorëve për të drejtën e informimit. Ndërkohë, që 26 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë instaluar dhe janë bërë pjesë e Regjistrin Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit (REKPDİ) në krahasim me 7 njësi të vetëqeverisjes vendore që e kishin instaluar në fund të vitit 2019.



Për sa i përket indeksimit të transparencës proaktive midis njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas monitorimit rezultojnë se 3 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “Transparencë Proaktive Negative” (semafor i kuq), pra i kanë të gjithë treguesit negativ dhe për këtë arsye kanë grumbulluar 0 pikë; 18 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “Transparencë Proaktive të Pamjaftueshme (semafor i verdhë), sepse kanë 1 nga 4 treguesit e monitorimit pozitiv, ndërsa 3 të tjerët janë vlerësuar me 0 pikë; 27 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “Transparencë Proaktive Minimale (semafor i bardhë), sepse kanë minimumi 2 tregues pozitiv dhe maksimumi 3 tregues pozitiv; si dhe 13 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “Transparencë Proaktive Funktionale” (semafor i gjelbër), sepse kanë të gjithë treguesit pozitiv.